

VENDIM
Nr. 87, datë 29.9.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “EFT ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, germa “a”; 9; 13 pika 1 germa “ç”; 45 pikat 3 dhe 4 dhe 48, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “P”, 5 pika 1 germa “P”, 8; 10, pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.9.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “EFT Albania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht (Mungon akti i themelimit të shoqërisë.).

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni finciar dhe fiskal është i plotësuar tërësisht.

Për aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike

- Neni 9, pika 4/9, germa “a”

(Mungon sasia e energjisë elektrike që parashikohet të tregtohet për pesë vitet e ardhshme.)

- Neni 9, pika 4/9, germa “b”

(Mungon niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët e kualifikuar.)

- Neni 9, pika 4/9, germa “c”

Mungon deklarimi i kapitalit financiar të vënë në dispozicion për realizimin e këtij aktiviteti.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

